

AKT-THEMELIMI
I
SHOQERISE TREGTARE "Atlas ArtStone & Construction "AASC"

SH.P.K.

Ne baze te ligjit nr 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" dhe në zbatim me ligjin nr.9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit",ligjit nr 129/2014 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin 9901 date 14/04/2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare " te ndryshuar , sot **ne daten 2022-04-01** behet themelimi i shoqerise **Atlas ArtStone & Construction "AASC" SH.P.K** me seli ne **Elbasan, Lagjja 5 Maji, zk.8527, pasuria nr.1/62.**

nga ortaku i kesaj Shoqerie **Znj. Alma Qendro**, i pajisur me karte identiteti me numer personal **I75316099T**

VENDOSIN

Te krijone nje Shoqeri Tregtare te emertuar **Atlas ArtStone & Construction "AASC" SH.P.K** me kushtet e meposhtme:

NENI I

Themeluesi ne cilesine e ortakut krijojn shoqerine tregtare **Atlas ArtStone & Construction "AASC" SH.P.K** me statusin juridik te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar ne kuptimin e ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare",ligjit 129/2014, me mjetet e veta financiare duke paguar kontributin ne para.

NENI 2

Shoqeria gezon statusin e personit juridik dhe veprimtaria e saj do te rregullohet nga legjislacioni shqiptar ne fuqi, nga ky Akt-Themelimi dhe statutin e bashkelidhur.

NENI 3

Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj me emertimin **Atlas ArtStone & Construction "AASC"SH.P.K** emer ky qe do te shenohet ne te gjitha dokumentat, letrat, faturat etj. Ajo ka vulen e saj ne te cilen eshte shkruar **Atlas ArtStone & Construction "AASC", SH.P.K, Elbasan, Albania.**

NENI 4



Shoqeria e ka seline e saj ne:

Elbasan, Lagjja 5 Maji, zk.8527, pasuria nr.1/62.

Ajo mund te hape perfaqesi, dege ose filiale edhe ne qytete te tjera te Shqiperise.

NENI 5

Afati i veprimtarise se Shoqerise do te jete i pakufizuar, me perjashtim te rastit kur ortaket vendosin prishjen e saj.

NENI 6

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj me objekt :

Studio artistike. Punime mermeri. Rikonstruksion objektesh (hidraulike, elektrike, lysterje,..etj). Agjenci shitje, shitje-blerje, tregtim me pakice dhe shumice, transformim, punim, ushtrim veprimtarie, transport kombetar dhe nderkombetar te artikujve te ndryshem dhe pjeseve te kembimit per automjete, import-eksport te mallrave te ndryshme, makineri te cdo lloj fushe te industrise, blerje shoqerish, dhenie konsulence, agjent shitje.

NENI 7

Me vendimin e themeluesit te saj, shoqeria mund te ndryshoje emrin, seline, formen juridike dhe objektin e veprimtarise, mbas berjes se ndryshimeve perkatese ne statut dhe ne kete akt themelimi.

NENI 8

Kapitali themeltar i shoqerise perfaqeson kontributet ne para dhe eshte **100.000** (njqindmije) leke shqiptare.
Ortaku Znj. **Alma Qendro** zoteron nje kuote me vlere **100.000 leke** ose **100 % te kapitalit themeltar.**

NENI 9

Shoqeria kryen veprimtarine e saj per te realizuar fitime. Ajo eshte pergjegjese per detyrimet qe ka ndaj shtetit dhe personave te tjere.

NENI 10



Shoqeria zhvillon veprimtarine e saj administruese, ekonomike, financiare ne perputhje me legjislacionin perkates ne fuqi dhe dispozitat e statutit bashkelidhur.

Shoqeria do te drejtohet nga organet drejtuese qe perbehen nga asambleja e ortakeve dhe administratori. Themeluesit me vendim te veçante do te emerojne dhe nje ekspert kontabel. Shoqeria do te mbaje llogarite ne perputhje me ligjin, " Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare", si dhe do te krijojte fondin rezerve.

Fitimi neto qe do te rezultojte ne fund te cdo viti financiar pas zbritjes se fondit rezerve dhe humbjeve te mbajtura nga vitet e meparshme do ti kaloje ortakeve.

NENI 11

Percaktimi i struktures organizative te shoqerise, numri i punonjesve dhe emerimet e shkarkimet ne organet e saj behen me vendim te asamblese se ortakeve. Administrator i Shoqerise emerohet **Z. Durim Koçi**, lindur ne Elbasan e banues ne Elbasan, i pajisur me karte identiteti me numer personal **I40221081D**

Maredheniet e punes do te bazohen ne kontratat e punes te lidhura mbi bazen e legjislacionit ne fuqi.

NENI 12

Rregullat per drejtimin, organizimin dhe prishjen e shoqerise jane percaktuar ne statutin qe i bashkelidhet ketij Akt-Themelimi.

THEMELUESIT E SHOQERISE TREGTARE

**"Atlas ArtStone & Construction "AASC" SH.P.K.
Alma Qendro**

